

**QEVERISJA E MIRË**

QEVERISJE E HAPUR DHE  
LLOGARIDHËNJE NË POLITIKË  
DHE PUSHTET

**Autore:** Blerina Ramaj – Open Data Kosovo

# **Qeverisja e hapur e pushtetit ekzekutiv në rajon dhe në Kosovë**

**Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale**



Ky publikim është prodhurar nga asistenca e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit ACTION SEE – Llogaridhënja, Teknologjia dhe Hapja institucionale në rajonin e Evropës Juglindore.





**Autore:** Blerina Ramaj – Open Data Kosovo

**Qeverisja e hapur e pushtetit  
ekzekutiv në rajon dhe në Kosovë**  
Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

Prishtinë, Shtator 2018

## HYRJE

Në bashkëpunim me partnerët nga rrjeti rajonal i OJQ-ve ActionSEE, Open Data Kosovo (ODK) hartoi një dokument që analizon nivelin e transparencës, hapjes dhe llogaridhënies së pushtetit ekzekutiv në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Dokumenti përbëhet nga rezultati i një hulumtimi gjithëpërfshirës i rrënjosur në metodologjinë rigoroze, të kryer nga anëtarët e rrjetit ActionSEE, në një periudhë prej disa muajsh. Qëllimi i hulumtimit është përcaktimi i gjendjes aktuale të rajonit përmes një matjeje objektive të nivelit të hapjes së pushtetit ekzekutiv dhe të ofrojë rekomandime për përmirësim. Projekti gjithashtu përpiqet të përmirësojë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë, ndër të cilat hapja e zë një vend të rëndësishëm.

Hapja duhet të jetë politike e të gjitha qeverive në rajon dhe duhet të projektohet në nivel të ngjashëm kujdesi dhe detajisht si politikat e tjera të rëndësishme. Politika e hapjes nuk duhet t'i nënshtrohet ndikimit të vullnetit politik, si dhe nuk duhet të jetë rezultat i një vendimi momental apo të gjendjes aktuale të pushtetit. Përderisa çdo vend rajonal ka kushtet specifike politike, rrethanat dhe sfidat e ndryshme, ka hapësirë për përpjekje të përbashkëta rajonale për të punuar drejt përmirësimit të nivelit të hapjes së organeve të tyre ekzekutive.

Njoftimi me konceptin e qeverisë së hapur në Ballkanin Perëndimor në shumicën e rasteve ishte diktuar nga proceset e integritetit apo ishte motivuar nga përmirësimi i reputacionit ndërkombëtar të një vendi përmes pjesëmarrjes në iniciativat për administrimin e hapur publik. Nevoja thelbësore e brendshme për hapje shpesh neglizhohet, pavarësisht nga fakti që hapja qeveritare për angazhimin e qytetarëve është një parakusht i rëndësishëm për krijimin e vlerave publike.

Kjo qasje çon drejt një problemi lidhur me zbatimin e rregullave të transparencës dhe hapjes, veçanërisht në nivelet më të ulëta të administratës publike, ku rëndësia shoqërore e kësaj qasjeje nuk është e njohur, por konsiderohet një detyrim i pakëndshëm i imponuar nga kërkesat ndërkombëtare. Prandaj, politika e hapjes në rajon kërkon jo vetëm që duhet të jetë pjesë e dokumenteve strategjike, por gjithashtu duhet të bëhet edhe avokim i zëshëm për konceptin e qeverisë së hapur në nivelet më të larta.

Propozimi ynë i drejtohet vendimmarrësve në të gjitha nivelet në vendet e Ballkanit Perëndimor: qeverive, ministrive dhe agjencitë ekzekutive. Ky dokument do të jetë me interes për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe kolegëve nga sektori i OJQ-ve që merren me çështjet përkatëse dhe publikun e gjerë që përpiqen të bëjnë më të hapur qeverinë e tyre.

Në mënyrë që të arrihet një dialog publik me cilësi më të lartë në lidhje me këto çështje, do të organizohet një seri ngjarjesh publike ku të gjithë akterët e interesuar do të ftohen të ndajnë pikëpamjet e tyre dhe të propozojnë zgjidhje të përbashkëta të qëndrueshme për zhvillim në këtë fushë. Përveç kësaj, do të respektojmë parimet e transparencës së hulumtimit dhe do t'i mbajmë institucionet përgjegjës për të gjitha detajet e përfundimeve të miratuara. Ne jemi të hapur, për sugjerime, kritika konstruktive dhe diskutime në lidhje me dokumentin tonë të politikave.

## Hapja e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon

Pas analizës së një numri të të dhënave të grumbulluara në mënyrë **metodologjike** kemi vërejtur ngjashmëri dhe dallime sa i përket gjendjes në këtë fushë brenda vendeve të **rajonit**. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se nga perspektiva rajonale e pushtetit ekzekutiv nuk është në një nivel të kënaqshëm. Në vend të progresit të pritshëm në fushën e transparencës, institucionet e pushtetit ekzekutiv në rajon kishin rezultate edhe më të këqija në krahasim me vitin e kaluar. Hapja Institucionale përafërsisht arrin në vetëm **38%** të treguesve të përmbushur, ndërsa përqindja për vitin e kaluar ishte më e lartë, në **41%**.

Si rikujtim, hulumtimi i kryer këtë vit kërkoi një nivel më të lartë të transparencës së institucioneve në krahasim me vitin e kaluar duke shtuar indikator të rinj për matjen e hapjes, duke i bërë kriteret më të rigorozë. Ne besojmë se një qasje e tillë hulumtuese më kërkuese rezultoi në rënie të hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Në anën tjetër, rezultatet dhe të dhënat e analizuara sugjerojnë se vetë institucionet në përgjithësi nuk kanë kryer asnjë aktivitet në zhvillimin e përgjithshëm të hapjes institucionale kështu që rritja e indikatorëve nuk paraqet kundërbalancim të rënies së hapjes. Siç është gjetur dhe theksuar në analizën e kryer në vitin e kaluar, si dhe këtë vit, politikat e hapjes institucionale të cilat janë të qarta, të qëndrueshme dhe të bazuara në dokumente strategjike nuk ekzistojnë. Të dhënat gjithashtu tregojnë se niveli i hapjes institucionale zvogëlohet duke filluar nga nivelet më të larta tek ato më të ulëta të qeverisë dhe organeve me aktivitete dhe politika që janë më afër qytetarëve.

Secili vend ka kushtet e veta specifike politike në të cilat zhvillon hapjen institucionale, me të cilën temë do të merremi në pjesën e dytë të këtij dokumenti, por mund të vërehet një hapësirë e theksuar për bashkëpunimin e përbashkët rajonal në lidhje me përmirësimin e situatës. Zvogëlimi në arritjen e indikatorëve në nivel rajonal, me përjashtim të Qeverisë së Maqedonisë që ka bërë përparim të dukshëm, tregon se institucionet e pushtetit ekzekutiv nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet në zhvillimin e hapjes së tyre gjatë vitit të kaluar. Fokusi i palëve të interesit në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ për zgjedhjet dhe procesin zgjedhor vitin e kaluar kishte ndikim vendimtar në prioritetet e përcaktuara nga qeveritë në vendet e rajonit, dhe hulumtimi ynë ishte konfirmim për këtë fakt.

Mungesa e qasjes strategjike ndaj hapjes është ende e dukshme në vendet e rajonit. Të dhënat e marra sugjerojnë se tek një numër i madh i rasteve ende nuk ka shprehje të hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv në dokumente përkatëse (strategjitë, procedurat ose politikat që lidhen me çështjet përkatëse). Megjithëse një numër i vogël i institucioneve të pushtetit ekzekutiv ka dokumente që në njëfarë mënyre rregullojnë hapjen e tyre, praktika nuk është e njëjtë, as në qasjen ndaj saj, as në llojin e dokumentit apo akteve nënligjore që rregullojnë atë çështje. Kjo njëtrajtshmëri nuk është e pranishme as në mes të vendeve të rajonit por as në institucionet e pushtetit ekzekutiv brenda një vendi. As pranimi i nismave ndërkombëtare që përkrahin transparencën dhe hapjen institucionale në vendet e rajonit nuk kontribuon në rritjen e përqindjes së indikatorëve të shënuara tek institucionet e pushtetit ekzekutiv. Mungesa e politikave të brendshme dhe synimi për të punuar në përmirësimin e këtyre fushave reflektohet qartë në pjesëmarrjen e vendeve në iniciativa të tilla.

Fakti se mungon vullneti për të punuar në përmirësim në fushën e hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon, është konfirmuar nga numri më i vogël i institucioneve të cilat kanë marrë pjesë aktive në hulumtimin e kryer dhe u janë përgjigjur pyetësorëve, pjesë kyçe e hulumtimit të përgjithshëm, në krahasim me vitin e kaluar. Mungesa e vullnetit për t'iu përgjigjur pyetjeve në pyetësor është vetë tregues i rënies së hapjes dhe mungesës së interesit në promovimin e hapjes institucionale.

Rekomandimi që dokumentet strategjike dhe planet vjetore të veprimit që adresojnë zhvillimin e hapjes institucionale duhet të miratohen ende qëndron që nga viti i kaluar. Brenda vendeve të rajonit është e nevojshme të planifikohet zhvillimi, por edhe të sigurohet njëtrajtshmëria e hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Pas futjes së planifikimit strategjik është e nevojshme të merret parasysh miratimi i Ligjit për Qeverinë dhe Ministrinë, meqë kjo do të ishte mënyra më efikase e trajtimit të kësaj çështjeje, por edhe të çështjeve të tjera në funksionimin e administratës publike.

Monitorimi ynë ka treguar disa "pika kritike", pra pengesa kritike për zhvillimin e transparencës në rajon.

## Transparenca dhe komunikimi

Edhe pse ka përkrahës dhe shembuj të praktikave të mira në **zbatimin e ligjeve për qasje të lirë në informata** në mesin e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon, ato nuk janë gjerësisht të pranishme, madje as brenda një vendi. Institucionet qeveritare ende ushtrojnë vullnetin e tyre politik në përcaktimin e nivelit tek i cili do të zbatohet ligji i lartpërmendur dhe nuk ndërmerren hapa në drejtim të futjes së avancimeve ligjore në fushën që ofron transparencë proaktive, kjo nënkupton publikimin e regjistrave dhe udhëzuesve për qasje në informata apo dhe botimin e të gjitha përgjigjeve ndaj kërkesave për qasje në informata.

Komunikimi me qytetarët është larg një niveli të kënaqshëm dhe në të ardhmen ne presim aktivitete të rëndësishme në përmirësimin e gjendjes aktuale nga institucionet publike. Situata mbetet e pandryshuar në fushën e mënyrave bashkëkohore të komunikimit me qytetarët dhe metodat klasike të komunikimit ende mbizotërojnë. Duhet që institucionet të fillojnë komunikimin edhe në forma të tjera përpos atyre me kërkesa zyrtare. Respektimi i parimit të publikimit të të dhënave në format **të të dhënave** të hapura, do të rriste disponueshmërinë dhe do të lehtësonte mbledhjen e të dhënave nga qytetarët. Mos publikimi i të dhënave në formë të hapur (openvdata) paraqet një problem rajonal, ku institucionet nuk janë të informuara në këtë drejtim.



## Planifikimi dhe shpenzimi i fondeve publike

Praktika e publikimit të informacioneve dhe dokumenteve financiare si dhe transparenca e shpenzimeve të fondeve publike është në nivel jashtëzakonisht të pakënaqshëm. Forcimi i transparencës financiare duhet të jetë në fokus dhe një nga prioritetet e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon në të ardhmen, prioritet ky që kërkon përpjekje të veçanta që duhet të ndërmerren në këtë drejtim.

Informatat mbi buxhetin, por edhe informatat se si shpenzimet e planifikuara që janë harxhuar publikohen shumë rrallë. Ministritë e Financave të vendeve të rajonit janë në shumicën e rasteve institucionet që kanë histori të të dhënave të publikuara, ndërsa institucionet e tjera të pushtetit ekzekutiv shumë pak dhe jo tërësisht e përdorin këtë mundësi. Buxheti për qytetarët dhe aftësia për të përfshirë qytetarët në procesin e planifikimit dhe shpenzimit të fondeve publike është mundësi e pashfrytëzuar nga institucionet rajonale të pushtetit ekzekutiv.

Gjithashtu, praktika e mos publikimit të planeve për prokurimet publike është ende gjërësisht e pranishme, ndërkohë që thirrjet dhe vendimet në lidhje me prokurimet publike, kontratat që i përkasin atyre, si dhe shtojcat e marrëveshjeve nuk janë në dispozicion në shumicën e rasteve.

## Efikasiteti dhe pritjet e qytetarëve nga pushtetet

Një çështje e rëndësishme e funksionimit të pushtetit ekzekutiv dhe hapjes së tij ndaj qytetarëve është krijimi i treguesve të qartë të suksesit të politikave qeveritare, të cilat do të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe sipas të cilave qytetarët mund të monitorojnë realizimin e politikave dhe shkallën e suksesit të tyre.

Qeveritë rajonale duhet të krijojnë metoda dhe procedura të vecanta për kontrollë të një cilësie të lartë të politikave të tyre, si dhe ato ende nuk kanë zhvilluar metoda adekuate për matjen e performancës së politikave të tyre. Nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme krijimit të një metode të veçantë sipas të cilës ministritë do të informonin Qeverinë për aktivitetet e tyre çdo vit. Të gjitha çështjet e përmendura reflektojnë negativisht në informimin e qytetarëve për ndikimin dhe efektet e punëve të kryera nga pushteti ekzekutiv.

## KOSOVA

### Hapja e Fuqisë Ekzekutive në Kosovë

Në matjet e këtij viti, të bazuara në indikatorët për Pushtetin Ekzekutiv, Kosova është renditur e treta në rajon duke shënuar 33% të indikatorëve. Nëse e krahasojmë me matjet e vitit të kaluar, Kosova renditej në vendin e tretë për nivelin e hapjes së fuqisë ekzekutive por me rezultat 39%, ekziston një diferencë që tregon që pushteti ekzekutiv nuk ka punuar në rritjen e hapjes por veçse ka neglizhuar atë.

Kosova nuk ka treguar ndonjë përparim në përmirësimin e pozitës së saj në krahasim me shtetet e tjera rajonale. Mungesa e planifikimit strategjik dhe promovimi i hapjes si një strategji kombëtare paraqet një pengesë të rëndësishme për përparimin e mëtejshëm. Hapja e pushtetit ekzekutiv nuk ka konsistencë dhe është e qasur në një mënyrë ad hoc, në vend se të trajtohet në mënyrë strategjike. Për më tepër, hapja zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme kur lëviz drejt organeve që janë më të ulëta në hierarki: Zyra e Kryeministrit, shënoi 41%, ndërkohë që Ministritë shënuan 37% dhe agjencitë ekzekutive shënuan 15%.

### Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit

Zyra e Kryeministrit mori rezultatin më të ulët rajonal të hapjes, me vetëm 41%. Nëse krahasohet me matjet e vitit të kaluar, ku Zyra e Kryeministrit shënoi 60% dhe renditet e dyta në rajon, ka një rënie të konsiderueshme. Edhe pse Zyra e Kryeministrit është më e vogël në numër të punonjësve dhe të dokumenteve të prodhuara, është për tu shqetësuar niveli i ulët i hapjes që ka kjo zyrë.

### Qasshmëria

Në përgjithësi, Kosova ka një problem kur është fjala për qasshmërinë, e cila lidhet me respektimin e procedurave për qasjen e lirë në informata. Në këtë kategori Kosova ka marrë rezultatin e dytë më të ulët duke shënuar 60%, duke lënë prapa vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën. Edhe pse ekziston infrastruktura për qasje në informacion dhe Ligji për Qasje në Dokumentet Publike, i cili rregullon mënyrën e funksionimit të QDP-së, ende mungon implementimi i tij në praktikë.

Institucioni ka një person të caktuar që merret me kërkesat e QDP-së dhe ka një afat kohor minimal të arsyeshëm për t'iu përgjigjur kërkesave. Megjithatë, e drejta për qasje në informacion nuk duket se zbatohet nga ndërmarrjet shtetërore, kompanitë publike, apo entitete të tjera që janë në pronësi apo të kontrolluara nga Qeveria. Institucionet nuk posedojnë ndonjë listë ose regjistër të dokumenteve në dispozicion dhe nuk i publikojnë ato, edhe pse parashihet nga ligji. Kjo praktikë do të thjeshtonte procedurën për zyrtarët publikë dhe aplikantët. Një mangësi e tillë është e zakonshme në të gjitha vendet e rajonit, mirëpo është relativisht e thjeshtë për t'u zbatuar dhe do të përmirësonte menjëherë rezultatin e Kosovës. Ekzekutivit kryesor gjithashtu i mungon një bashkëveprim më aktiv me qytetarët; Kosova, e ngjashme me vitin e kaluar, shënoi rezultatin më të ulët në këtë komponent nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor. Si hap i parë drejt përmirësimit të këtij aspekti të hapjes do të ishte çasja në mënyra më bashkëkohore të bashkëveprimit me qytetarët, si Tëitter dhe Facebook. Kosova poashtu shënoi rezultatin më të ulët në rajon për indikatorët e konsultimeve publike, sepse vendi nuk krijoi asnjë lloj mekanizmi, i cili do t'u mundësonte qytetarëve dhe palëve të interesuara që të shqyrtojnë vendimet e marra nga zyra e Kryeministrit e cila nuk ka realizuar proces të duhur për konsultime publike për çdo vendim që është ndërmarrë deri më tani, pra kjo është një fushë shumë e rëndësishme për përmirësim.

## Ndërgjegjësimi

Kosova mori rezultatin e dytë më të ulët në ndërgjegjësim, duke shënuar vetëm 25%, dhe duke lënë prapa vetëm Serbinë, e cila mori një rezultat prej 18%. Vërehet një përmirësim i vogël nga matja e fundit, ku Kosova u rendit e fundit në rajon, duke shënuar 24%. Një nga elementet kryesore që mungon në Zyrën e Kryeministrit është vlerësimi dhe monitorimi i përgjithshëm i projekteve dhe politikave, në të cilat Kosova ka shënuar 0% në bazë të indikatorëve; kështu, Kosova u rendit i fundit në rajon.

Një pasqyrë kontekstuale tregon se Kosova është ekspozuar ndaj shumë projekteve dhe politikave të orientuara nga donatorët. Megjithatë, nuk ekziston një mekanizëm për monitorimin e performancës së këtyre projekteve dhe politikave dhe ndikimin e programeve dhe planeve të reformës. Progresi ose regresi nuk dokumentohen, gjë që përbën një sfidë të madhe ndaj hapjes, si dhe një rrezik joefikasiteti. Komponenti i vetëm në fushën e Ndërgjegjësimit në të cilën Kosova ka marrë një rezultat prej 100% është komponenti i raportimit të Ministrisë, ku Kosova e ndan këtë rezultat me Maqedoninë.

## Integriteti

Kjo është një fushë në të cilën Zyra e Kryeministrit është duke punuar mirë, me një rezultat prej 82% në bazë të indikatorëve, Kosova u rendit e dyta menjëherë pas Malit të Zi. Kjo lidhet kryesisht me deklarimin e pasurisë nëpërmjet kartave të aseteve, të cilat menaxhohen nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ku në studimin tonë bien nën kategorinë e Integritetit. Indikatorët e integritetit lidhen me deklarimin e pasurisë, kodin e sjelljes dhe konfliktin e interes, ku në të tria, proceset janë të rregulluara dhe i japin këtij institucioni një rezultat më të lartë.

## Transparenca

Transparenca matet në mes të tre komponentëve: informacioni organizativ, prokurimi publik dhe transparenca buxhetore. Kosova ka shënuar vetëm 29% në bazë të këtyre indikatorëve, duke u renditur e fundit në rajon. Një nga mangësitë më të mëdha të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës është transparenca buxhetore. Faqja zyrtare nuk përmban shpenzimet buxhetore dhe llogaritë përfundimtare. Nuk ka informacion për nivelin dhe përbërjen e borxhit (nëse egziston) dhe mënyrën se si menaxhohet borxhi. Web-faqja e Ministrisë së Financave përmban buxhetin e përgjithshëm që mbulon shpenzimet e përgjithshme të institucioneve të Kosovës, mirëpo faqja e internetit e zyrës së Kryeministrit nuk siguron informacion të qasshëm, të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës mbi buxhetin e planifikuar dhe shpenzimet qeveritare.

## Informacionet mbi nivelin Organizativ

Sa i përket transparencës në informacionin organizativ, Zyra e Kryeministrit të Kosovës ka shënuar 36% në bazë të indikatorëve të caktuar duke u renditur e fundit në rajon edhe një herë, gjë që tregon një rënie krahasuar me matjet e vitit të kaluar në të cilën Kosova shënoi 63%. Në përgjithësi, faqja e internetit është e pasur me njoftime për shtyp të seancave të Qeverisë, dokumente zyrtare, raporte, strategji, plane vjetore të punës dhe deri në një masë me informacione mbi shërbyesit civilë. Megjithatë, ekziston një problem me konsistencën dhe organizimin e dokumenteve të tilla brenda faqes së internetit. Jo gjithmonë informacioni është i paraqitur në dy gjuhët zyrtare të vendit, i cili është një kusht brenda Kushtetutës, raportet janë të shpërndara dhe nuk ndjekin ndonjë strukturë specifike.

## Prokurimi Publik

Problemi kryesor në të gjithë rajonin është kur flitet për transparencën është prokurimi publik. Kosova renditet e fundit në rajon dhe vendoset prapa Malit të Zi, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë, me një rezultat prej vetëm 32% bazuar në indikatorët e caktuar. Ndërkohë që në matjen e fundit në 2016, Kosova shënoi 40%. Faqja e internetit e Zyrës së Kryeministrit nuk i posedon planet dhe rezultatet e prokurimit. Një mënyrë efektive për përmirësimin e rezultatit të transparencës do të ishte publikimi i rregulloreve, planeve dhe rezultateve të prokurimit në faqen e internetit në mënyrë që të jenë të qashe për qytetarët.

## Ministritë

Ministritë e Kosovës përmbushin kriteret e hapjes me 37%, mirëpo ka rënie krahasuar me matjet e vitit të kaluar ku vendi mori një rezultat prej 41%. Kosova renditet parafundit në rajon, duke lënë prapa vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën, e cila mori një rezultat prej 27% bazuar në indikatorët e caktuar. Mali i Zi është renditur e para, duke shënuar 61% në bazë të indikatorëve. Ministria më e hapur në Kosovë është Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila ka shënuar një rezultat prej 66% të indikatorëve dhe pasohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka shënuar një rezultat prej 58%. Sa i përket ministrisë me rezultatin më të ulët në hapje, është Ministria e Punëve të Jashtme, e cila shënoi vetëm 19% në bazë të indikatorëve të caktuar.

## Qasshmëria

Ministritë e Kosovës përmbushin kriteret e hapjes me 37%, mirëpo ka rënie krahasuar me matjet e vitit të kaluar ku vendi mori një rezultat prej 41%. Kosova renditet parafundit në rajon, duke lënë prapa vetëm Bosnjën dhe Hercegovinën, e cila mori një rezultat prej 27% bazuar në indikatorët e caktuar. Mali i Zi është renditur e para, duke shënuar 61% në bazë të indikatorëve. Ministria më e hapur në Kosovë është Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila ka shënuar një rezultat prej 66% të indikatorëve dhe pasohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila ka shënuar një rezultat prej 58%. Sa i përket ministrisë me rezultatin më të ulët në hapje, është Ministria e Punëve të Jashtme, e cila shënoi vetëm 19% në bazë të indikatorëve të caktuar.

## Ndërgjegjësimi

Sa i përket Ndërgjegjësimit, Ministritë e Kosovës, në krahasim me komponentët e tjerë, kanë marrë rezultate më të larta, duke shënuar 55% në bazë të indikatorëve. Edhe pse ky rezultat është një nga më të lartat në rajon, ende mbetet i ulët në monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve dhe ndikimin e reformave të tyre.

## Integriteti

Ministritë e Kosovës shënuan vetëm 7% në fushën e integritetit. Kjo fushë matet duke u bazuar në punën që bëhet për parandalimin e konfliktit të interesit brenda Ministrisë. Shumica e ministrive gjatë vitit 2016/2017 nuk kanë mbajtur asnjë trajnim apo aktivitet edukativ për zyrtarët e tyre lidhur me çështjet e parandalimit të konfliktit të interesit, korrupsionit / keqtrajtimit ose si të trajtohen parregullsitë.

## Transparenca

Ministritë e Kosovës gjithashtu morën rezultate të ulëta në komponentin e Transparencës, me një rezultat prej 43%, duke u renditur e parafundit në rajon. Buxheti mbetet një fushë e dobët e transparencës për ministritë e Kosovës ku vetëm gjashtë ministri kanë publikuar informacionet e tyre buxhetore. Ministritë e Kosovës shënuan rezultatet më të larta në Transparencën e informacionit organizativ (57%). Pikët e transparencës së prokurimit publik dallojnë shumë nga një ministri në tjetrën; disa dështuan plotësisht me një rezultat prej 0%, ndërsa të tjerët arritën pothuajse një maksimum prej 80%. Kjo na bën të besojmë se nuk ka ndonjë plan ose strategji të qëndrueshme për transparencën e prokurimit publik dhe rezultatet janë rrjedhojë e nismave individuale brenda ministrive. Rezultati i transparencës potencialisht mund të përmirësohet duke publikuar planet e prokurimit publik dhe duke bërë thirrje për prokurime publike në faqet e internetit.

## Agjencitë Ekzekutive

Agjencitë ekzekutive përmbushin vetëm 15% të indikatorëve të hapjes, duke u renditur në fund të listës prapa Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë.

Pikët e indikatorëve në përgjithësi për Agjencionet Ekzekutive, në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, janë shumë të ulëta. Në pozitë më të mirë në lidhje me hapjen është Agjencia e Statistikave, e cila ka marrë një rezultat prej 33% bazuar në indikatorët, ndërkohë që Këshilli Ndërmintor i Ujërave ka marrë një rezultat prej 0% në bazë të indikatorëve; gjë që ndikon në vlerësimin e agjencisë ekzekutive si jo të hapur.

Faqet e internetit të këtyre organeve nuk janë të përditësuara dhe në shumicën e rasteve, përdorimi i tyre është shumë i vështirë apo thjeshtë informacionet mungojnë. Agjencitë shënuan 14% në aspektin e qasjes në informacion, ndërveprim dhe monitorim të qytetarëve. Asnjë nga agjencitë ekzekutive nuk kanë publikuar buxhetet në faqet e tyre. Kjo përbën një rrezik të jo-transparencës në buxhet.

## Metodologjia e Hulumtimit

Hapja është një kusht kyç për demokracinë, pasi që i lejon qytetarët të marrin informacionin e nevojshëm për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendim-marrje efektive dhe mbajtje të institucioneve përgjegjëse për politikën e tyre. Institucionet anembanë botës ndërmarrin aktivitete me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve. Indeksi rajonal i nivelit të hapjes së pushtetit ekzekutiv krijohet me qëllim të vlerësimit se deri në çfarë mase qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informacion të qashtë dhe të kuptueshëm nga institucionet e tyre.

Indeksi rajonal i nivelit të hapjes bën matjen se deri në çfarë mase janë të hapura institucionet për qytetarët dhe shoqërinë duke u bazuar në katër parimet e mëposhtme: transparencën, qashtësinë, integritetin dhe efektivitetin. Parimi i **transparencës** përfshin faktin se informacioni organizativ, buxheti dhe prokurimi publik të jenë publikisht të disponueshme dhe të publikuara. **Qashtëria** ka të bëjë me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informata, përmirësimin e disponueshmërisë së informacionit nëpërmjet një mekanizmi të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. **Integriteti** përfshin mekanizma për parandalimin e korrupsionit, zbatimin e kodeve të sjelljes dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, **ndërgjegjësimi**, lidhet me monitorimin dhe vlerësimin e politikave të bëra nga institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime zhvillohen më tej përmes indikatorëve të veçantë sasiorë dhe cilësorë, të cilët vlerësohen në bazë të: qashtësisë në faqet zyrtare të internetit të institucioneve, cilësisë së kornizës ligjore për çështje individuale, burimeve të tjera të informimit publik dhe pyetësorëve të dërguara në institucione.

Përmes 80 indikatorëve për institucion, ne kemi arritur të masim dhe analizojmë hapjen e 275 institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon dhe kemi grumbulluar mbi 15000 të dhëna të institucioneve.

Matja është realizuar nga muaji Dhjetor 2017 deri më Shkurt 2018. Një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh drejt institucioneve publike janë zhvilluar duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit.



## Rreth ActionSEE

ACTION SEE (Accountability, Technology and Institutional Openness Network in the South East Europe region) është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku në promovimin e llogaridhënjes në regionin e Evropës Jug-Lindore, duke ngritur potencialin për aktivizëm qytetar, promovimin e të drejtave të njeriut dhe liritë në internet, dhe duke ndërtuar kapacitetet dhe interesimin brenda shoqërisë civile për të përdorur teknologjinë për promovimin e demokracisë.

Antarët themelor të organizatës janë Metamorphosis nga Maqedonia, Center for Democratic Transition nga Mali i Zi, Center for Research, Transparency and Accountability nga Serbia, dhe Why Not nga Bosnja dhe Herzegovina. ACTIONSEE punon me partnerët nga Shqipëria të organizatës MJAFT! dhe Open Data Kosovo nga Kosova.

### OPEN DATA KOSOVO

**Adresa:** "Ganimete Tebeshi" Street, 26A  
10 000 Prishtina, Kosovo

**Email:** [info@opendatakosovo.org](mailto:info@opendatakosovo.org)

**Website:** [www.opendatakosovo.org](http://www.opendatakosovo.org)







This project is funded by  
the European Union

METAMORPHOSIS 

 WESTMINSTER  
FOUNDATION FOR  
DEMOCRACY

 CENTER FOR RESEARCH  
TRANSPARENCY AND  
ACCOUNTABILITY

**ZaštoNe?** 

 CENTAR ZA  
DEMOKRATSKU  
TRANZICIJU

 ODK  
OPEN DATA KOSOVO

 MJAJT!

The "Accountability, Technology and Institutional Openness Network in South East Europe - ACTION SEE" project is implemented by Metamorphosis Foundation, Westminster Foundation for Democracy, CARTA – Center for Research, Transparency and Accountability, Citizens Association Why not?, Center for Democratic Transition, Open Data Kosovo (ODK) and Levizja Mjajt!